



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. 3483 / 6 prot.

Pogradec, më 18.09, 2025

Lënda:

Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

**Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dokumentacionim justifikues dhe relacionin shoqërues, për: *“Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive”*.

Me respekt,

**KRYETARI
Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit + rregullorja: 5 (Pesë).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3 (Tre)

Vendimi i Asamblese së Përgjithshme: 2 (Dy).

Vendim i Këshillit të Administrimit: 2 (Dy).

Vendimi i Këshillit Artistiko – Kulturor + rregullorja: 4 (Katër).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADec
KRYETARI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2025

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORË, ARTISTIKË DHE SPORTIVE**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "k" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetore dhe enteve publike"; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", si dhe në zbatim të Vendimin të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021, me propozim të shoqërisë Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", me qëllim:

- Rritja e cilësisë dhe diversitetit të aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive në nivel vendor.
- Mbështetje më e drejtë dhe efektive për organizatat dhe individët.
- Forcimi i transparencës në përdorimin e fondeve publike.
- Përfshirja më e gjerë e komunitetit në jetën kulturore dhe sportive.
- Përcaktimi i Procedurave të aplikimit për financim.
- Saktësimi i kriterëve të përzgjedhjes së projekteve.
- Mekanizmat e vlerësimit nga komisionet përkatëse.
- Menaxhimi financiar dhe mënyrat e raportimit.
- Detyrimet e subjekteve përfituese dhe masat në rast shkeljesh.



3. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, Këshilli Artistiko – Kulturor, dhe Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a.
4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
5. U shpall sot më datë __.__.2025.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË POGRADEC

Nr. 3489 Prot.

Pogradec, më 18.09.2025

RREGULLORE

**PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE DHE
SPORTIVE**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "k" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", si dhe në zbatim të Vendimin të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunktionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunktionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021, me propozim të shoqërisë Qendra Multifunktionale Pogradec Sh.a dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Në kuptim të kësaj rregullore do të quhet:

1. Projekt kulturor – artistik - sportiv, çdo aktivitet që zhvillon vlera për artin, kulturën, turizmin, sportin etj.

2. Mbështetja e Bashkisë Pogradec, nëpërmejt Qendrës Multifunkzionale Pogradec Sha, për projekte artistike – kulturore - sportive, të paraqitura nga persona fizikë e juridikë privat, vendas dhe të huaj si dhe shtetas shqiptarë të fushës së artit dhe kulturës, që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore, sportin, për këto fusha jepen në formën:

- Me ambiente që administrohen nga Qendra Multifunkzionale Pogradec Sha, ku zhvillohen aktivitete, si salla për shfaqje, ekspozita, panaire etj.

- Në mjete financiare, në formë mbështetje financimi.

3. Mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga Bashkia Pogradec sipas buxhetit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të alokuara tek buxheti i Qendrës Multifunkzionale Pogradec Sha.

4. Bashkia Pogradec do të ketë prioritet për mbështetjen e projekteve të cilat janë të mbështetura ose janë pjesë e programeve të ndryshme kulturore dhe me gjërë të Komunitetit Europian.

PROCEDURAT E ÇELJES DHE MIRATIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

1. Pasqyrimi i dokumentacionit që plotëson kërkesat sipas destinimit si dhe specifikave të Qendrës Multifunkzionale Pogradec Sha.
2. Qendra Multifunkzionale Pogradec Sha shqyrton projektin me objektivat dhe programin e Bashkisë sipas projektit të paraqitur, së bashku me preventivin përkatës (të lartë ose të detajuar në bazë të zhanrit artistik).

DOKUMENTAT QË DUHET TË DORËZOHEN NË MOMENTIN E PUBLIKIMIT TË PROJEKTIT

1. Kërkesë për përfitim financiar e protokolluar në Q.M.P. Sha.
2. Projekti artistik – kulturor, ndërtuar në bazë të të dhënave të përcaktuara në format e dorëzuara.
3. Ekstrakti i shoqërisë ose Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë; Akti i themelimit; NIPT, fotokopje e statutit dhe e aktit të themelimit.
4. Vërtetim që Shoqëria/subjekti nuk është në proces likuidimi apo likuiduar.
5. Numri i llogarise bankare, IBAN.
6. Preventivi, total i detajuar me të gjitha zerat e tij, përkatës të jenë shënuar donatorët përkatës.
7. Preventivi pjesor, për zerat që kerkohen nga Qendra Multifunkzionale Pogradec Sha.
8. Deklarata mbi autorësinë e projektit, nëse objekti artistik është individual.
9. Në rastin e bashkëpunimeve duhet të përcaktohet roli i pjesëmarrësve përkatës.
10. Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
11. CV dhe/ose aktiviteti artistik.

Shënim: Në rast se kërkesa paraqitet nga një individ, duhet të paraqitet një biografi personale, CV dhe projekt të aktivitetit përkatës.

PROCEDURA E GJYKIMIT DHE MIRATIMIT PER FINANCIMIN E PROJEKTIT

1. Paraqitja e dokumentacionit te plote te kerkuar sipas detajimit me lart.
2. Drejtoria, Qendra Kulturore "Lasgush Poradeci", prane Qendres Multifunksionale Pogradec Sha, vlereson dhe gjykon perputhjen e projektit te paraqitur me programin e Bashksie Pogradec, dhe se bashku me preventivat e tyre i kalon per miratim ne Keshillin Artistiko – Kulturor.
3. Keshilli Artistiko – Kulturor, i miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët përfaqësojnë fusha të ndyshme.
4. Afati maksimal i shqyrtimit të projektit mbas dorëzimit në Q.M.P Sha është 15 ditë.
5. Mbas miratimit të projektit nga Keshilli Artistiko - Kulturor, ky i fundit del me vendim dhe autorizon administratorin te nënshkruajë kontraten perkatese me shoqatën/fondacionin, personin fizik dhe juridik duke përcaktuar edhe fondet që do të përdoren për këto projekte.

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET PAS KRYERJES SË AKTIVITETIT NGA FITUESI

1. Në rastin kur është shoqeri, shoqatë ose person juridik duhet të lëshojë një faturë te fiskalizuar për llogari të Q.M.P, për shumën që është mbështetur
2. Situacionin (duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga zbatuesi, të ketë date dhe të jetë i rakorduar me faturat për shpenzimet e kryera).
3. Raport financiar me të gjithë donatorët (situacioni faktik i preventivit total).
4. Relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impakti i tij në publik, dhe marrjen në dorëzim të projektit.
5. foto, si dhe materiale të tjera, dokumentare mbi zhvillimin e aktivitetit.

Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, Këshilli Artistiko – Kulturor, dhe Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunksionale Pogradec Sh.a.

**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



**QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC SHA
ADMINISTRATORI**

Nr. 140 . Prot.

Pogradec, më 12 . 9 .2025

**RELACION
PËR PROJEKT- VENDIMIN**

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKË DHE SPORTIVË.**

E NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Këshilli i Bashkisë Pogradec me Vendimin Nr. 50, datë 29.05.2025, “Për krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 12.06.2025, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, vendosi, të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor pranë Bashkisë Pogradec, i cili do të shërbejë si organ vendimarrës, këshillues dhe vlerësues te Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a, me përbërje si më poshtë:

1. Kudret DUROLLARI	KRYETAR	PIKTOR
2. Edmond GUSHO	ANËTAR	KOMPOZITOR
3. Ilir SHYTA	ANËTAR	PEDAGOG LETRAR

Këshilli Artistiko – Kulturor, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të veta, me Vendimin Nr. 06, datë 19.06.2025, vendosi të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportivë, sipas tekstit bashkëngjitur.

Ky vendim/rregullore ka hyrë në fuqi menjëherë dhe gjithashtu pika 2 e saj, ngarkon administratën e shoqërisë, Qendra Multifunkionale Pogradec Sha që rregulloren ta miratojë edhe tek Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme dhe më pas të miratohet tek Këshilli i Bashkisë Pogradec.

Nga ana e Administratës u morën të gjitha masat për miratimin e rregullores në Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme, sipas vendimeve bashkëngjitur.

Për sa më lart, në përfundim të procedurës së sipërcituar, po relatojmë si më poshtë vijon:

Bashkia Pogradec, nëpërmjet Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, në kuadër të kompetencave si dhe referuar aktit të themelimit dhe statutit, kanë për detyrimin të mbështesin zhvillimin e jetës kulturore, sportive dhe artistike, si një element themelor i përfshirjes sociale dhe i identitetit komunitar.

Për sa më sipër, përveç projekteve që realizohen nga artistët e Qendrës Kulturore, "Lasgush Poradeci" dhe Drejtoria e Sporteve, në kuadër të sezonit turistik dhe pasurimin e jetës kulturore – artistike – sportive, lind nevoja që të miratohen edhe projekte të cilat zhvillohen nga organizata jofitimprurëse, institucione, shoqata sportive, grupe të pavarura apo individë krijues, brenda territorit të Bashkisë.

Por, nga analizimi i gjithë kuadrit ligjor, kemi konstatuar se aktualisht mungon një mekanizëm i detajuar, i standardizuar dhe i aksesueshëm, mbi bazën e të cilit të realizohet shpërndarja e fondeve publike nga ana e Njesive Vendore apo Shoqerive Aksionere me kapital shtetëror, për këto iniciativa, si më poshtë:

Neni 26 i ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën" (i ndryshuar) përcakton se: "1. **Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën**, nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, financon:

- a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën;
- b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik. 3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 24.10.2012 "Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave artistiko-kulturore dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre" përcakton procedurat që ndiqen për financimin e projekteve në kuadër të artit dhe kulturës, ku specifikohet se këto fonde nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik.

Vendimi Nr. 709, datë 24.10.2012, "Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore", e cili kishte për qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe të procedurës për shpalljen e konkurrimit për:

- a) projektide për veprimtari të ndryshme artistike dhe kulturore;
- b) realizimin e veprimtarive kulturore e artistike nga subjekte private, si dhe nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën (festa kombëtare, nderim figurash, përvjetore të mëdha dhe rast pas rasti). Ngarkohet ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën për zbatimin e këtij vendimi.

Nga analizimi i Ligjit, dhe Aktit nënligjor, rezulton se për zbatimin e detyrimeve ligjore ngarkohet vetëm **ministria për artin dhe kulturën**, dhe ne asnjë nen apo fjali NUK përmendet njesite vendore/Bashkia.

I vetmi akt nenligjor per zbatim nga njesite vendore ngelej vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturore dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, te cilen ne e kemi zbatuar me krijimin e Keshillit Artistiko – Kulturor.

Duke qene se jemi ne kete “Boshellek ligjor”, qe rregullon kete veprimtari, gjejme mbeshtetje tek shkronja “k”, e nenit 54 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku ngarkon Këshillin Bashkiak, si më poshtë:

k) miraton norma, standarde e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

PËRFUNDIM:

Hartimi i kësaj rregulloreje siguron transparencë, konkurrencë të ndershme dhe mbështetje të barabartë për aktorët e ndryshëm.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e përfshirjes së aktorëve të ndryshëm, në aktivitete kulturore, sportive dhe artistike, si dhe domosdoshmërinë e një kuadri të qartë rregullues, paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak projekt-vendimi “Për miratimin e Rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive”.

Vendimi i Këshillit Bashkiak përbën një akt normativ nënligjor, mbi të cilin mbështeten të gjitha procedurat.

Për sa më sipër mendojmë se projektvendimi i ri bashkëngjitur është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Koneptuan:

E. SHKULAKU

B. MEÇO

Pranoi: DREJTOR

Klevis CANE

Miratoi: ADMINISTRATOR Dorian LATIFLLARI

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI

QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC Sh.a
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

VENDIM

NR. ____ , DATË ____ . ____ . 2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORË, ARTISTIKË DHE SPORTIVE.

Sot më datë ____ . ____ . 2025, Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Qendra Multifunkionale Pogradec Sha, u mbledh në ambjentet e Bashkisë Pogradec, për të zhvilluar mbledhjen e vet për të diskutuar për rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive.

Nga analizimi i dokumentacionit, rezulton se:

Këshilli i Bashkisë Pogradec me Vendimin Nr. 50, datë 29.05.2025, "Për krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij", i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 12.06.2025, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", vendosi, të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor pranë Bashkisë Pogradec, i cili do të shërbejë si organ vendimarrës, këshillues dhe vlerësues të Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a.

Këshilli Artistiko – Kulturor, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të veta, me Vendimin Nr. 06, datë 19.06.2025, vendosi të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur.

Ky vendim/rregullore ka hyrë në fuqi menjëherë dhe gjithashtu pika 2 e saj, ngarkon administratën e shoqërisë, Qendra Multifunkionale Pogradec Sha që rregulloren ta miratojë edhe tek Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme dhe më pas të miratohet tek Këshilli i Bashkisë Pogradec.

Për sa më sipër, në mbështetje të; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe

shpërblimin e tyre”, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", dhe Vendimit Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021,



KËSHILLI I ADMINISTRIMIT VENDOSI:

1. Ti propozojë Asamblesë së Përgjithshme, që të konfirmojë Vendimin e Këshillit Artistiko – Kulturor Nr. 06, datë 19.06.2025, "Për miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive".
2. Rregullorja e financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive, sipas teksit bashkëngjitur Vendimit Nr. 06, datë 19.06.2025, të miratohet edhe në Këshilli i Bashkisë Pogradec.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet, Administratori i Shoqërisë Qendra Multifunkionale Pogradec Sha.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT:

**ANËTAR
ERINDA KAMOLLI**

**KRYETAR
ALMA KANINA**

**ANËTAR
ERVISA SELMANLLARI**

QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC Sh.a
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më _____.2025

VENDIM

NR. _____, DATË _____.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORË, ARTISTIKË DHE SPORTIVE.

Sot më datë _____.2025, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a, e perfaqësuar nga z. Ilir XHAKOLLI, në cilësinë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, me 100 % të aksioneve, u mbledh në ambjentet e Bashkisë Pogradec, për të zhvilluar mbledhjen e vet për të diskutuar për rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive.

Duke qënë se ne mbledhje është prezent personalisht ortaku i vetem i shoqërisë, perkatesisht: z. Ilir XHAKOLLI, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, pasi u njoh me vendimin e paraqitur nga Këshilli i Administrimit dhe dokumentacioni i dorezuar nga Administrata e Shoqërisë, Qendra Multifunkionale Pogradec Sha dhe Keshilli Artistiko – Kulturor,

KONSTATOHET SE:

Këshilli i Bashkisë Pogradec me Vendimin Nr. 50, datë 29.05.2025, “Për krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 12.06.2025, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, vendosi, të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor pranë Bashkisë Pogradec, i cili do të shërbejë si organ vendimarrës, këshillues dhe vlerësues te Qendra Multifunkionale Pogradec Sh.a.

Këshilli Artistiko – Kulturor, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të veta, me Vendimin Nr. 06, datë 19.06.2025, vendosi të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur.

Ky vendim/rregullore ka hyrë në fuqi menjëherë dhe gjithashtu pika 2 e saj, ngarkon administratën e shoqërisë, Qendra Multifunkionale Pogradec Sha që rregulloren ta miratojë edhe tek Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme dhe më pas të miratohet tek Këshilli i Bashkisë Pogradec.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", dhe Vendimit Nr.110, datë 02.12.2021, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021,

VENDOSA:

1. Të konfirmoj Vendimin e Këshillit Artistiko – Kulturor Nr. 06, datë 19.06.2025, “Për miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive”.
2. Rregullorja e financimit të projekteve kulturore, artistikë dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur Vendimit Nr. 06, datë 19.06.2025, të miratohet edhe në Këshilli i Bashkisë Pogradec.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Administratori i Shoqërisë Qendra Multifunksionale Pogradec Sha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË POGRADEC

**(NË CILËSINË E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC Sh.a)**

ILIR XHAKOLLI





BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI ARTISTIKO - KULTUROR

Nr. 88/8 Prot.

Pogradec, më 19.06.2025

VENDIM

NR. 06, DATË 19.06.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORË, ARTISTIKË DHE SPORTIVE.

Në mbështetje të; nenit 28 dhe nenit 29 të Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", *si dhe në zbatim të Vendimin të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 50, datë 29.05.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 12.06.2025, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", Këshilli Artistiko – kulturor pranë Bashkisë Pogradec, pasi u njoh me dokumentacionin e dorëzuar nga Administrata e Shoqërisë, Drejtoria e Kulturës, Qendra Kulturore, "Lasgush Poradeci",*

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e financimit të projekteve kulturorë, artistikë dhe sportive, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e shoqërisë që këtë rregullore ta paraqesë për miratim edhe tek Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme, e shoqërisë dhe më pas tek Këshilli i Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI ARTISTIKO – KULTUROR:

Kudret DUROLLARI

Kudret Durrallari Kryetar


Edmond GUSHO

Edmond Gusho Anëtar

Ilir SHYTA

Ilir Shyta Anëtar

Këshilli Artistiko – Kulturor



BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI ARTISTIKO - KULTUROR

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ . 2025

RREGULLORE

PER
FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE DHE
SPORTIVE

Këshilli Artistiko – Kulturor, pasi u njoh posaçërisht me detyrimet që rrjedhin nga; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.540, datë 21.12.1992, “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.121, datë 25.2.2005, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, si dhe në zbatim të Vendimin të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 50, datë 29.05.2025, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 509/1 Prot, datë 12.06.2025, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, Këshilli Artistiko – kulturor, si dhe në kuadër ushtrimit të kompetencave të veta,

VENDOSI:

Të miratojë rregulloren për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Në kuptim të kësaj rregullore do të quhet:

1. Projekt kulturor – artistik - sportiv, çdo aktivitet që zhvillon vlera për artin, kulturën, turizmin, sportin etj.

2. Mbështetja e Bashkisë Pogradec, nëpërmejt Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha, për projekte artistike – kulturore - sportive, të paraqitura nga persona fizikë e juridikë privat, vendas dhe të huaj si dhe shtetas shqiptarë të fushës së artit dhe kulturës, që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore, sportin, për këto fusha jepen në formën:

- Me ambiente që administrohen nga Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, ku zhvillohen aktivitete, si salla për shfaqje, ekspozita, panairë etj.

- Në mjete financiare, në formë mbështetje financimi.

Këshilli Artistiko – Kulturor

3. Mbështetja financiare do të kryhet në përputhje me fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga Bashkia Pogradec sipas buxhetit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të alokuara tek buxheti i Qendrës Multifunkzionale Pogradec Sha.

4. Bashkia Pogradec do të ketë prioritet për mbështetjen e projekteve të cilat janë të mbështetura ose janë pjesë e programeve të ndryshme kulturore dhe me gjërë të Komunitetit European.

PROCEDURAT E ÇELJES DHE MIRATIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

1. Pasqyrimi i dokumentacionit që plotëson kërkesat sipas destinimit si dhe specifikave të Qendrës Multifunkzionale Pogradec Sha.
2. Qendra Multifunkzionale Pogradec Sha shqyrton projektin me objektivat dhe programin e Bashkisë sipas projektit të paraqitur, së bashku me preventivin përkatës (të lartë ose të detajuar në bazë të zhanrit artistik).

DOKUMENTAT QË DUHET TË DORËZOHEN NË MOMENTIN E PUBLIKIMIT TË PROJEKTIT

1. Kërkesë për përfitim financiar e protokolluar në Q.M.P. Sha.
2. Projekti artistik – kulturor, ndërtuar në bazë të të dhënave të përcaktuara në format e dorëzuara.
3. Ekstrakti i shoqerise ose Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë; Akti i themelimit; NIPT, fotokopje e statutit dhe e aktit të themelimit.
4. Vërtetim qe Shoqëria/subjekti nuk është në proces likuidimi apo likuiduar.
5. Numri i llogarise bankare, IBAN.
6. Preventivi, total i detajuar me të gjitha zerat e tij, perkrah te jene shenuar donatoret perkates.
7. Preventivi pjesor, per zerat qe kerkohen nga Qendra Multifunkzionale Pogradec Sha.
8. Deklarata mbi autorësinë e projektit, nese objekti artistik është individual.
9. Në rastin e bashkëpunimeve duhet të përcaktohet roli i pjesëmarrësve përkatës.
10. Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit.
11. CV dhe/ose aktiviteti artistik.

Shënim: Në rast se kërkesa paraqitet nga një individ, duhet të paraqitet një biografi personale, CV dhe projekt të aktivitetit perkates.

PROCEDURA E GJYKIMIT DHE MIRATIMIT PER FINANCIMIN E PROJEKTIT

1. Paraqitja e dokumentacionit të plotë të kerkuar sipas detajimit me lart.
2. Drejtoria, Qendra Kulturore “Lasgush Poradeci”, pranë Qendres Multifunkzionale Pogradec Sha, vlereson dhe gjykon përputhjen e projektit të paraqitur me programin e Bashkisë Pogradec, dhe se bashku me preventivat e tyre i kalon për miratim në Këshillin Artistiko – Kulturor.
3. Këshilli Artistiko – Kulturor, i miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët përfaqësojnë fusha të ndryshme.
4. Afati maksimal i shqyrtimit të projektit mbas dorëzimit në Q.M.P Sha është 15 ditë.

5. Mbas miratimit të projektit nga Keshilli Artistiko - Kulturor, ky i fundit del me vendim dhe autorizon administratorin të nënshkruajë kontraten perkatese me shoqatën/fondacionin, personin fizik dhe juridik duke përcaktuar edhe fondet që do të përdoren për këto projekte.

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET PAS KRYERJES SË AKTIVITETIT NGA FITUESI

1. Në rastin kur është shoqeri, shoqatë ose person juridik duhet të lëshojë një faturë të fiskalizuar për llogari të Q.M.P, për shumën që është mbështetur
2. Situacionin (duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga zbatuesi, të ketë date dhe të jetë i rakorduar me faturat për shpenzimet e kryera).
3. Raport financiar me të gjithë donatorët (situacioni faktik i preventivit total).
4. Relacion mbi zhvillimin e aktivitetit dhe impakti i tij në publik, dhe marrjen në dorëzim të projektit.
5. foto, si dhe materiale të tjera, dokumentare mbi zhvillimin e aktivitetit.

**Ngarkohet Administratori dhe Drejtoria, Qendra Kulturore, "Lasgush Poradeci", për
zbatimin e kësaj rregullore.**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Kudret DUROLLARI

Kudret Duvollari **Kryetar**

Edmond GUSHO

Edmond Gusho **Anëtar**

Ilir SHYTA

Ilir Shyta **Anëtar**